



Hapat për faljen e borxhit

1

Konstatoni Statusin e Borxhit Tuaj

Borxhi juaj për vitet 2001-2008 nuk është mbi 100 €

&

Borxhi juaj për vitet 2009-2014 është 0 €



Ju nuk duhet të bëni asgjë. Borxhi juaj për vitet 2001-2008 do të falet automatikisht.

Borxhi juaj për vitet 2001-2008 nuk është mbi 100 €

&

Borxhi juaj për vitet 2009-2014 është më shumë se 0 €



Borxhi juaj për vitet 2001-2008 do të falet automatikisht. Për falje për dënime dhe kamatë për vitet 2009-2014 shkoni tek hapi 2.

Borxhi juaj për vitet 2001-2008 është mbi 100 €

&

Borxhi juaj për vitet 2009-2014 është 0 €



Ju nuk duhet të bëni asgjë. Borxhi juaj për vitet 2001-2008 do të falet automatikisht.

Borxhi juaj për vitet 2001-2008 është mbi 100 €

&

Borxhi juaj për vitet 2009-2014 është më shumë se 0 €



Shkoni tek hapi 2.

Borxhi juaj për vitet 2001-2008 është 0 €

&

Borxhi juaj për vitet 2009-2014 është mbi 0 €



Shkoni tek hapi 2.

Varësisht nga statusi i borxhit, janë disa veprime të cilat duhet të ndërmerren.

- Nëse borxhi total për tatimin e llogaritur për vitet 2001-2008 nuk është mbi 100€ ai do të falet automatikisht së bashku me të gjitha dënimet dhe kamatën për vitet 2001-2008.
- Personat të cilët nuk kanë asnjë borxh për vitet 2009-2014 nuk kanë nevojë të bëjnë asgjë. Të gjitha borxhet e tyre për vitet 2001-2008 do të falen automatikisht.
- Personat me borxh për vitet 2001-2008 me mbi 100€ dhe personat me borxh për vitet 2009-2014 duhet të veprojnë për të përfituar nga falja e borxheve.

Ju keni dy zgjidhje te ndryshme.

2



Nënshkruani deklaratën për borxhin e pajtuar

Gjatë nënshkrimit të kësaj, ju pajtoheni me shumën e borxhit dhe me faktin se borxhi është i juaji.

3



Nënshkruani deklaratën mbi poseduesin faktik

Kjo nënshkruhet për të vërtetuar që ju jeni poseduesi i pronës në pyetje.

Nëse ju jeni pronar ligjor por pronësia nuk është regjistruar siç duhet, ju lutemi shkoni në Zyren Kadastrale Komunale për të regjistruar pronësinë e saktë.

4




a. Bëni pagesë të plotë të tatimit të llogaritur për vitet 2009-2014

ose



b. Nënshkruani një marrëveshje për pagesë me këste



Ju duhet të veproni më së voni deri më 1 Shtator 2017.

Nëse nuk e bëni këtë, ju do të duhet të paguani të gjitha borxhet në të ardhmen, duke përfshirë kamatën nga viti 2015 dhe tutje.

- Nëse bëni **pagesë të plotë** të gjithë tatimit të llogaritur nga viti 2009-2014, ju paguani vetëm tatimin e llogaritur për vitet 2009-2014. Gjithçka tjetër falet.
- Nëse **nënshkruani një marrëveshje për plan** me këste ju duhet të paguani të gjithë tatimin e llogaritur dhe gjithë kamatën për vitet 2009-2014. Gjithçka tjetër do të falet.

Mbani mend që nëse nuk i përmbaheni planit të pagesës me këste, marrëveshja ndërpritet dhe ju nuk përfitoni nga falja e borxheve.

Një person fizik do të ketë plan të pagesës me këste për 3 vite. Shuma për t'u paguar do të ndahet në 18 këste.

Një person ligjor do të ketë plan të pagesës me këste për 2 vite. Shuma për t'u paguar do të ndahet në 12 këste.